

Bastisjet në Batllavë dhe Fushë Kosovë, gjenden armë dhe municione



09:29 | 25 Shkurt 2021

Njësitë policore të mërkurës kanë bastisur disa lokacione, si dhe fshatin Batllavë të Komunës së Podujevës dhe në Fushë Kosovë ku janë gjetur armë dhe municione.

Sipas raportit të Policisë së Kosovës në fshatin Batllavë gjatë bastisjes në dy shtëpi janë konfiskuar: një pushkë gjuetie, një pushkë automatike me 18 fishekë dhe 55 fishekë të kalibrit 7.57 mm, dy pistoleta, një AK-47, një pistoletë dhe 176 fishekë të kalibrave të ndryshëm.


“Fsh. Batllavë 24.02.2021 – 08:48. Njësitë policore, gjatë një bastisje në një shtëpi pronë, e të dyshuarit mashkull kosovar, ka gjetur dhe konfiskuar: një pushkë gjuetie, një AK-47, një pistoletë dhe 168 fishekë të kalibrave të ndryshëm. I dyshuari është intervistuar dhe me konsultim të prokurorit rasti mbetet të hetohet në procedurë të rregullt.

Fsh. Batllavë 24.02.2021 – 13:15. Njësitë policore, gjatë një bastisje në një shtëpi pronë, e të dyshuarit mashkull kosovar ka gjetur dhe konfiskuar: një pistoletë nëntë fishekë, një pushkë automatike me 18 (tetëmbëdhjetë) fishekë dhe 55 (pesëdhjetë e pesë) fishekë të kalibrit 7.57mm. I dyshuari është intervistuar dhe me konsultim të prokurorit rasti mbetet të hetohet në procedurë të rregullt”, thuhet në raport.

Ndërkaq, gjatë bastisjes në banesën e një personi tjetër në Fushë Kosovë janë gjetur dhe konfiskuar një armë me tre fishekë të së njëjtës armë.

“Rr. Bedri Pejani, Bresje, Fushë Kosovë 24.02.2021 – 10:23. Gjatë bastisjes në banesën e të dyshuarit mashkull kosovar kanë gjetur dhe konfiskuar një armë me tre fishekë të së njëjtës armë. Është njoftuar prokurori i cili udhëzon që rasti të procedohet pasi që i dyshuari vazhdon me procedura të tjera nga njësitë i Krimeve Ekonomike”, thuhet ndër të tjera në raportin e Policisë së Kosovës.

Shpërndaje në rrjete sociale



POLICIA E KOSOVES

Lajmet më të lexuara

Të ngjashme



Bastisjet në Batllavë dhe Fushë Kosovë, gjenden armë dhe municione

— 09:29 | 25 February 2021



Sulmohet fizikisht një femër në Fushë Kosovë

— 09:24 |



Lirohet njëri nga 12 të arrestuarit në aksionin e djeshëm

— 09:15 |

Foto lajm



2 vendet e pazakonta ku u fshehën çantat me para të zyrtarëve të Ministrisë

16:06 | 24 Shkurt 2021

Rreth nesh

Arbresh.info është në shërbimin tuaj 24 orë duke u kujdesur që në kohë reale të përcjellë tek ju vetëm lajme të sakta, korrekte dhe profesionale, nga gazetarë profesionist dhe të dëshmuar. Lajmi i saktë është vlera që e diferencon Arbresh.info nga portalet tjera.

Kontakt

Tel: +383 38 224 955
Mob: +383 49 777 000
E-Mail: info@arbresh.info
Redaksia: redaksia@arbresh.info
Adresa: Kompleksi Qafa,
Rruga UÇK, Kati I, Hyrja 1,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Rrjetet sociale

